



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.239/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Rustem Thaqi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë.07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa Anr.239/2019, të datës 05.10.2019, e paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 400.00 (katërqind) euro, për shkak të vazhimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilën shumë, subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.239/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se në llogarinë zyrtare në Facebook Ad library, shihet se në ditën e heshtjes zgjedhore me datën 05.10.2019, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik PDK, Mustafa Grainca, në Facebook ka plotë 11 reklama active. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Në përgjigjiën në ankes të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), theksojn se kandidati për deputet Mustafa Grainca në bazë të dëshmive të ofruara shihet se nuk ka qenë aktiv ne rrjetin social facebook në ditën e heshtjes zgjedhore dhe për këtë kan ofruar dëshmi dy fotografi.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerësoi se ankesa Anr.239/2019, e datës 05.10.2019 e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ndaj kandidatit për deputete Mustafa Grainca, nga radhët e subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), shihet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore me dt. 05.10.2019 dhe ditës së votimit dt. 06.10.2019, në llogarin e tij në rrjetin social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr. 97, veprim të cilin kandidati për deputet Mustafa Grainca, e ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Andaj PZAP-i, duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është përgjegjës për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.239/2019 më datë 07.10.2019

Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.